

L I G J
Nr.8004, datë 4.10.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7906, DATË 4.4.1995
“PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 1995”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

“Miratohet buxheti i shtetit i vitit 1995 i paraqitur nga Këshilli i Ministrave, i cili përbëhet nga:

- Të ardhurat 54 400 milionë lekë
- Shpenzimet 88 668 milionë lekë”

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon:

“Burimet për mbështetjen e shpenzimeve të buxhetit janë në total 34.268 milionë lekë, të specifikuara si vijon:

- | | |
|---|---------------------|
| - kredi e Bankës së Shqipërisë dhe bonot e thesarit | 16 600 milionë lekë |
| - kredia e huaj..... | 17 668 milionë lekë |

Neni 3

Përfundimisht për vitin 1995 kredia e Bankës së Shqipërisë do të jetë më e lartë sesa parashikohet në ligjin nr.7559, datë 22.4.1992 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë përcaktojnë masën e financimit të deficitit buxhetor nga kredia e Bankës së Shqipërisë dhe nga bonot e thesarit, duke pasur parasysh zhvillimet monetare për të ruajtur objektivat e politikës monetare për vitin 1995.

Neni 4

Në nenin 5, zëri “Rezervë/kontigjencë” nga 4.344 milionë lekë bëhet 6.944 milionë lekë.

Neni 5

Në nenin 6, pas fjalëve “... për rritjen e pagave dhe pensioneve gjatë vitit...”, shtohen fjalët “... për rritjen e investimeve...”.

Neni 6

Në nenin 7 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Në këtë listë objektsh Këshilli i Ministrave ka të drejtë të bëjë ndryshimet përkatëse”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.1258, datë 30.10.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**